



Bazuar në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.17 dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nenin 85, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, si dhe në zbatim të Rregullores për Treguesin e Leverazhit, Bordi Ekzekutiv, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2019, miratoi këtë:

## **UDHËZIM METODOLOGJIK PËR RAPORTIMIN PËR TREGUESIN E LEVERAZHIT**

Data efektive: 1 janar 2020

Qëllimi i këtij udhëzimi metodologjik është të përcaktojë metodologjinë e raportimit të treguesit të leverazhit të bankave. Ky udhëzim metodologjik është përpiluar në funksion të zbatimit të Rregullores për Treguesin e Leverazhit dhe hyn në fuqi më 1 janar 2020.

1. Formulari mbi Treguesin e Leverazhit përfshinë të dhënat mbi masën e ekspozimit siç definohet në Rregulloren për Treguesin e Leverazhit.

2. Formulari mbi Treguesin e Leverazhit përbëhet nga katër pjesë: a) zërat bilancor, b) derivativët dhe zërat jashtëbilancor, c) ekspozimet nocionale të rregulluar për derivativët kreditor të shkruar, d) llogaritja e treguesit të leverazhit.

### 3. Zërat bilancor

Ekzistojnë katër kolona për zërat bilancor, për vlerën e ekspozimeve të derivativëve, transaksionet e financimit të letrave me vlerë dhe asetet tjera. Tri kolonat e para kërkojnë vlerën kontabël dhe vlerën bruto, dhe për transaksionet e financimit të letrave dhe derivativët kërkohet vetëm ekspozimi i rrezikut kreditor i kundërpalës. Kolona e katërt aplikohet vetëm për ekspozimet e transaksioneve të financimit të letrave me vlerë dhe kërkon rregullimin e transaksioneve të financimit të letrave me vlerë bruto si pozicioni i aseteve.

#### 3.1. Vlerat kontabël sipas raportimit në pasqyrat financiare të bankave

Kolona 1 kërkon të dhëna sipas raportimit në pasqyrat financiare të bankave. Të dhënat në këtë kolonë duhet të përputhen me të dhënat sipas raportimit në pasqyrat financiare (duke marrë parasysh fushëveprimin e konsolidimit rregullator). Këto të dhëna duhet të jenë neto nga provizionet specifike dhe përshtatjet rregullatore dhe përfshijnë efektet e kompensimit në bilanc të gjendjes si rezultat i marrëveshjeve të netimit dhe zbutjes së rrezikut kreditor.

#### 3.2. Derivativët

Rreshtat 6,7 dhe 8 të këtij formulari kërkojnë të dhëna mbi vlerën e drejtë pozitive të derivativëve, sipas raportimit në pasqyrat financiare të bankës që mund të pasqyrojnë efektin e kompensimit të bilancit të gjendjes si rezultat i marrëveshjeve të netimit dhe zbutjes së rrezikut kreditor.

#### 3.3. Transaksionet e financimit të letrave me vlerë

Rreshtat 12 dhe 13 kërkojnë të dhëna mbi shumat bilancore për transaksionet e financimit të letrave me vlerë duke i ndarë transaksionet e agjentëve të pranueshme për trajtim të veçantë sipas Nenit 8, paragrafit 6 dhe 7 të Rregullores për Treguesin e Leverazhit nga të gjitha transaksionet e financimit të letrave me vlerë tjera si pozicione të aseteve. Shumat mund të pasqyrojnë efektet e kompensimit të bilancit të gjendjes si rezultat i marrëveshjeve të netimit dhe zbutjes së rrezikut kreditor.

#### 4. Vlerat bruto

Kolona 2 kërkon të dhëna për tu regjistruar duke përdorur shumën e vlerave kontabël (neto nga provizionet specifike dhe rregullimet e vlerësimit), duke supozuar mospërfshirjen e netimit kontabël apo efektet e zbutjes së rrezikut kreditor (d.m.th., vlerat bruto). Zërat që nuk janë të pranueshëm për netimin kontabël apo subjekt i zbutjes së rrezikut kreditor duhet të jenë të njëjtë sikurse ata zëra të raportuar në kolonën 1.

##### 4.1. Derivatvët

Rreshtat 6,7 dhe 8 përfshijnë vlerën bruto të të gjitha shumave të ekspozimeve derivative ( përfshirë derivativët e trajtuar si zëra jashtë-bilancor sipas kornizës kontabël të aplikueshme), duke supozuar mospërfshirjen e netimit kontabël dhe efektet e zbutjes së rrezikut kreditor.

Në rreshtin 17 duhet të raportohet shuma e çdo kolaterali derivativ e dhënë përveç margjinës fillestare për transaksionet derivative të shlyerjes për klientët me kundërpalën qëndrore të kualifikuar dhe margjina ndryshuese në para të gatshme e pranueshme siç definohet në Nenin 7, paragrafi 8 dhe 9 të Rregullores për treguesin e leverazhit, ku provizioni i atij kolaterali e ka zvogëluar vlerën e bilancit të gjendjes. Ngjashëm , asetet e pranueshme për margjinën ndryshuese në para të gatshme të pranueshme që është dhënë në transaksionet derivative sipas paragrafëve 8 dhe 9 të nenit 7 të Rregullores për treguesin e leverazhit duhet të raportohen në rreshtin 18 nëse bankës i kërkohet të njohë këto asete të arkëtueshme. Margjina fillestare e dhënë për kundërpalën qendrore të kualifikuar si rezultat i transaksioneve derivative të shlyerjes për klientët me kundërpalën qëndrore të kualifikuar ku banka vepron si anëtar për shlyerje dhe përjashton margjinën fillestare të tillë nga masa e ekspozimit të treguesit të leverazhit me paragrafin 11 të nenit 7 të Rregullores për treguesin e leverazhit, duhet të raportohet në rreshtin 19.

##### 4.2. Transaksionet e financimit të letrave me vlerë

Rreshtat 12 dhe 13 kërkojnë që Transaksionet e financimit të letrave me vlerë si pozicione të aseteve të raportohen duke mos njohur netimin kontabël të (parave) zërave të pagueshëm kundrejt (parave) zërave të arkëtueshëm duke i ndarë agjentët e transaksioneve të pranueshëm për trajtim të veçantë, sikurse rregullohet me paragrafët 6 dhe 7 të nenit 8 të Rregullores për treguesin e leverazhit, nga të gjitha transaksionet e financimit të letrave me vlerë tjera si pozicione të aseteve.

#### 5. Ekspozimet e rrezikut kreditor të kundërpalës pas aplikimit të standardeve rregullatore të netimit

Kolona 3 kërkon raportimin e ekspozimeve të rrezikut kreditor të kundërpalës të derivativëve dhe transaksioneve të financimit të letrave me vlerë pas aplikimit të efekteve të netimit rregullator (jo të rregullave kontabël të netimit siç aplikohet sipas kolonës 1). Të dhënat nuk duhet të përfshijnë efekte tjera të zbutjes së rrezikut kreditor.

##### 5.1. Derivatvët

Në rreshtin 5 bankat duhet të raportojnë koston zëvendësuese të pozicioneve derivative bruto nga margjina ndryshuese në para të gatshme dhe duke përdorur standardet e netimit, duke përfshirë pozicionet si rezultat i aplikimit të paragrafit 13 të nenit 7 të Rregullores për treguesin e leverazhit. Kolaterali i pranuar nuk duhet të netohet kundrejt pozicioneve derivative (neto). Nëse një transaksion derivativ nuk është i mbuluar sipas një marrëveshje netimi të kualifikuar, shuma e ekspozimit derivativ duhet të raportohet në bazë bruto, njëjtë sikurse shuma e raportuar në kolonën 2.

Rreshti 9 kërkon shumën në para të gatshme të margjinës ndryshuese të pranuar dhe kompensimin e pranueshëm kundrejt pjesës së koston zëvendësuese të ekspozimeve derivative sipas paragrafit 8 dhe 9 të nenit 7 të Rregullores për treguesin e leverazhit.

Rreshti 10 kërkon pjesën e koston zëvendësuese të ekspozimeve tregtare të përjashtuara ndaj një kundërpale qëndrore të kualifikuar nga transaksionet derivative të shlyerjes së klientëve, ku banka e cila vepron si anëtar i shlyerjes nuk obligohet të rimbursojë klientin për humbjen e shkaktuar për shkak të ndryshimeve në vlerën e transaksioneve në rast të dështimit të kundërpalës qëndrore të kualifikuar sikurse rregullohet në paragrafin 11 të nenit 7 të Rregullores për treguesin e leverazhit.

## 5.2. Transaksionet e financimit të letrave me vlerë

Për transaksionet e financimit të letrave me vlerë, vlera e ekspozimit të rrezikut kreditor të kundërpalës përcaktohet si gjithsej shuma e vlerës së drejtë të letrave me vlerë dhe parasë së gatshme të huazuar ndaj një kundërpale për të gjitha transaksionet e përfshira në marrëveshjen netuese të kualifikuar, duke zbritur gjithsej shumën e vlerës së drejtë të parasë së gatshme dhe letrave me vlerë të pranuar nga kundërpala për ato transaksione në një nivel minimal prej zero.

Në rastet kur nuk ekziston marrëveshje netimi e kualifikuar, vlera e ekspozimit të transaksionit të financimit të letrave me vlerë e kundërpalës duhet të llogaritet në bazë të secilit transaksion (që do të thotë, secili transaksion i financimit të letrave me vlerë trajtohet sikurse grup netimi i veçantë) sikurse rregullohet me paragrafin 4 të nenit 8 të Rregullores për treguesin e leverazhit. Këto shuma duhet të raportohen në rreshtat 12 dhe 13 duke i ndarë transaksionet e agjentëve të pranueshme për trajtim të veçantë nga të gjitha transaksionet e financimit të letrave me vlerë tjera si pozicione të aseteve, sikurse rregullohet me paragrafët 6 dhe 7 të nenit 8 të Rregullores për treguesin e leverazhit.

## 6. Transaksionet e financimit të letrave me vlerë bruto të rregulluara si pozicione asete

Rreshti 13 i kolonës 4 kërkon që bankat të raportojnë shumat e transaksioneve të financimit të letrave me vlerë bruto si pozicione asete për të gjitha transaksionet e financimit të letrave me vlerë përveç transaksioneve të agjentëve të pranueshme për trajtim të veçantë sikurse rregullohet me nenin 8, paragrafët 6 dhe 7 të Rregullores për treguesin e leverazhit dhe sipas nenit 8, paragrafit 3 të nënparagrafit 3.2 të Rregullores për treguesin e leverazhit.

Tabela 1. Zërat Bilancor

Udhëzimet për pozicionet specifike

Rreshti	Kolona	Referencat ligjore dhe udhëzimet
1=2+3	1,2	<b>Ekspozimet bilancore</b> Neni 6 të Rregullores për treguesin e leverazhit
2	1,2	Zërat bilancor (duke përjashtuar derivativët dhe transaksionet e financimit të letrave me vlerë, por duke përfshirë kolateralin)
3	1,2	Shuma e aseteve e zbritur për të përcaktuar Kapitalin e klasës së parë
4=6+7+8 4=5-9-10	1,2 3	<b>Derivativët</b> Neni 7 par.1 deri 13 të Rregullores për treguesin e leverazhit
5	3	Kosto zëvendësuese e lidhur me të gjitha transaksionet derivative (bruto nga margjina ndryshuese). Kosto zëvendësuese e derivativëve duke përdorur efektet e netimit dhe duke mos e njohur kolateralin (në para të gatshme apo jo në para të gatshme), shih nenin 7, par.1-6 dhe 13 të Rregullores për treguesin e leverazhit.
6	1,2	Derivativët kreditor (mbrojtja e shitur) Vlerat e drejta pozitive të derivativëve kreditor të shkruar (d.m.th., në rastet kur banka jep mbrojtje kreditore ndaj një kundërpale). Kolona 1 duhet të raportohet në bazë neto dhe kolona 2 duhet të raportohet në bazë bruto.
7	1,2	Derivativët kreditor (mbrojtja e blerë) Vlerat e drejta pozitive të derivativëve kreditor të blerë (d.m.th., në rastet kur banka jep mbrojtje kreditore ndaj një kundërpale). Kolona 1 duhet të raportohet në bazë neto dhe kolona 2 duhet të raportohet në bazë bruto.
8	1,2	Derivativët financiar Vlera e drejtë pozitive e derivativëve financiar (p.sh., derivativët e normave të interesit, derivativët e këmbimit valutor dhe të arit, derivativët e kapitalit, etj.). Kolona 1 duhet të raportohet në bazë neto dhe kolona 2 duhet të raportohet në bazë bruto.
9	3	Margjina ndryshuese në para të gatshme e pranueshme e kompensuar kundrejt vlerave të tregut të derivativëve Margjina ndryshuese në para të gatshme e arkëtuar që pranohet për tu kompensuar kundrejt pjesës së koston zëvendësuese të ekspozimeve derivative sipas nenit 7, par.8,9 dhe 10 të Rregullores për treguesin e leverazhit. Shuma e raportuar gjithashtu duhet të përfshihet në koston zëvendësuese bruto të raportuar në rreshtin 5.
10	3	Ana e kundërpalës qendrore e përjashtuar për ekspozimet e shlyera tregtare të klientëve (kosto zëvendësuese) Pjesa e koston zëvendësuese për ekspozimet tregtare të shlyera ndaj një kundërpale qendrore të kualifikuar nga transaksionet derivative të shlyera të klientëve, ku banka duke vepruar si anëtarë i kliringut

		nuk është i obliguar për të rimbursuar klientin për humbjet e shkaktuara për shkak të ndryshimeve në vlerën e transaksioneve në rastet kur kundërpala qëndrore e kualifikuar dështon, shih nenin 7, par. 11 të Rregullores për treguesin e leverazhit. Shuma e raportuar gjithashtu duhet të përfshihet në kostot zëvendësuese bruto të raportuara në rreshtin 5.
11=12+13 11=13	1,2,3 4	<b>Transaksionet e financimit të letrave me vlerë</b> Neni 8 i Rregullores për treguesin e leverazhit
12	1,2,3	<p>Transaksionet e agjentëve të financimit të letrave me vlerë të pranueshme për trajtim të veçantë</p> <p>Vetëm transaksionet e agjentëve për financimin e letrave me vlerë ku banka duke vepruar si agjent jep dëmshpërblim apo garanci ndaj një klienti apo kundërpale që kufizohet në diferencën ndërmjet vlerës së letrës me vlerë të parasë së gatshme që klienti ka huazuar dhe vlerës së kolateralit që huamarrësi ka dhënë janë të pranueshme për këtë trajtim të veçantë. Shih nenin 8, par. 6 dhe 7 të Rregullores për treguesin e leverazhit.</p> <p>Kolona 1 duhet të raportohet neto nga provizionet specifike dhe rregullimet e vlerës dhe përfshinë efektet e marrëveshjeve të netimit dhe zbutjes së rrezikut kreditor.</p> <p>Kolona 2 duhet të raportohet duke mos njohur netimin kontabël të zërave të pagueshëm (në para të gatshme) kundrejt zërave të arkëtueshëm (në para të gatshme).</p> <p>Letrat me vlerë të huazuara në një transaksion të financimit të letrave me vlerë që mbeten të njohura në bilanc të gjendjes nuk duhet të përfshihen këtu por në rreshtin 15.</p> <p>Vlera e letrave me vlerë e pranuar në një transaksion të financimit të letrave me vlerë që janë të njohura si aset duhet të raportohen në rreshtin 20.</p> <p>Letrat me vlerë të huazuara në një transaksion të financimit të letrave me vlerë që nuk janë të njohura për shkak të transaksionit kontabël në shitje nuk duhet të përfshihen këtu, por në rreshtin 21.</p> <p>Të gjitha transaksionet e financimit të letrave me vlerë të tregtuara jashtë bursave (ang. OTC), në bursa dhe nëpërmjet një kundërpale qëndrore duhet të përfshihen.</p>
13	1,2,3,4	<p>Transaksionet e financimit të letrave me vlerë tjera</p> <p>Transaksionet e financimit të letrave me vlerë përveç transaksioneve të financimit të letrave me vlerë të agjentëve të raportuar në rreshtin 12.</p> <p>Kolona 1 duhet të raportohet neto nga provizionet specifike dhe rregullimet e vlerësimit dhe mund të përfshijë efektet e netimit dhe zbutjes së rrezikut kreditor.</p>

		<p>Kolona 2 duhet të raportohet pa e njohur netimin kontabël të pozicioneve të pagueshme (në para të gatshme) kundrejt pozicioneve të arkëtueshme (në para të gatshme).</p> <p>Letrat me vlerë të huazuara në një transaksion të financimit të letrave me vlerë që mbeten të njohura në bilanc të gjendjes nuk duhet të përfshihen këtu por në rreshtin 15.</p> <p>Vlera e letrave me vlerë e pranuar në një transaksion të financimit të letrave me vlerë që është e njohur si aset duhet të raportohet në rreshtin 20.</p> <p>Letrat me vlerë të huazuara në një transaksion të financimit të letrave me vlerë që nuk janë të njohura për shkak të transaksionit kontabël në shitje nuk duhet të përfshihen këtu, por në rreshtin 21.</p> <p>Të gjitha transaksionet e financimit të letrave me vlerë të tregtuara jashtë bursave (ang. OTC), në bursa dhe nëpërmjet një kundërpale qëndrore duhet të përfshihen.</p>
14=15+16	2	Asetet tjera
15	1,2	<p>Asetet tjera kontabël</p> <p>Çdo aset tjetër që nuk është identifikuar në mënyrë specifike në asnjë nga rreshtat 4 deri 13 më lartë (p.sh., çdo aset tjetër kontabël që nuk është përfshirë në zëra të derivativëve apo transaksioneve të financuar me letra me vlerë, p.sh., të arkëtueshmet kontabël për margjinën ndryshuese të dhënë në para të gatshme).</p> <p>Kjo përfshinë çdo instrument (përfshirë parane e gatshme) të huazuar apo të dhënë hua përmes një transaksioni të financimit të letrave me vlerë kur kjo është raportuar në bilancin e gjendjes.</p>
16=17-18-19-20+21-22	2	Rregullimet në asetet tjera kontabël për qëllime të raportit të leverazhit.
17	2	<p>Asetet e mbledhura (ang. Grossed-up) për kolateralin e dhënë të derivativëve</p> <p>Shuma e çdo kolaterali të dhënë të derivativëve kur provizioni për atë kolateral ka zvogëluar vlerën e aseteve të bilancit të gjendjes, shih Nenin 7, par. 7 të Rregullores për treguesin e leverazhit .</p>
18	2	<p>Të arkëtueshmet për margjinën ndryshuese në para të gatshme të pranueshme që është dhënë në transaksionet e derivativëve</p> <p>Të arkëtueshmet për margjinën ndryshuese në para të gatshme të ranueshme që është dhënë në transaksionet e derivativëve nëse bankës i kërkohet të njohë këto si asete, shih Nenin 7, par. 8 dhe 9 të Rregullores për treguesin e leverazhit.</p> <p>Shuma e raportuar gjithashtu duhet të përfshihet në asetet tjera kontabël në rreshtin 15.</p>

19	2	Ana e kundërpalës qëndrore e përjashtuar për ekspozimet e shlyera tregtare të klientëve (margjina fillestare) Pjesa e margjinës fillestare nga ana e kundërpalës qëndrore e përjashtuar për ekspozimet e shlyera tregtare ndaj kundërpalës qëndrore të kualifikuar nga transaksionet e shlyera tregtare të derivativëve të klientëve, kur banka që vepron si anëtar kliringu nuk obligohet të rimbursojë klientin për asnjë humbje të pësuar për shkak të ndryshimit të vlerës së transaksioneve të saj në rast se kundërpala qëndrore e kualifikuar dështon. Shih Nenin 7, par. 11 të Rregullores për treguesin e leverazhit. Shuma e raportuar gjithashtu duhet të përfshihet në asetet tjera kontabël të raportuara në rreshtin 15.
20	2	Letrat me vlerë të pranuar nga transaksioni i financuar me letra me vlerë që janë njohur si aset. Letrat me vlerë të pranuar nga transaksioni i financuar me letra me vlerë që janë njohur si aset dhe lejohen sipas kornizës kontabël dhe janë përfshirë në rreshtin 15, shih Nenin 8, par. 2,3 dhe 4 të Rregullores për treguesin e leverazhit.
21	2	Rregullimet për transaksionet kontabël të shitjes për transaksionet e financimit të letrave me vlerë Vlera e letrave me vlerë të dhënë hua në transaksionin e financimit të letrave me vlerë që janë çregjistruar për shkak të shitjes së transaksionit kontabël, shih Nenin 8, par. 5 të Rregullores për treguesin e leverazhit.
22	2	Asetet e besuara (ang. fiduciary) Neni 6 par.1 të Rregullores për treguesin e leverazhit
23	1,2,3,4	Gjithsej shuma

## 7. Derivatvët dhe zërat jashtë-bilancor

7.1. Ekspozimet e mundshme të së ardhmes të derivativëve të vlerësuara duke përdorur metodën e ekspozimit aktual me përjashtim të efektit të netimit përfshijnë vetëm vlerën shtesë (ang. add-on) për ekspozimin e mundshëm të së ardhmes, meqenëse totali i kostos zëvendësuese tashmë është i përfshirë në zërat bilancor. Të dhënat e vlerës shtesë për derivativët që kanë vlerë të drejtë negative (dhe me këtë nuk raportohen si zëra bilancor), duhet të përfshihen gjithashtu.

7.2. Gjatë bashkimit të zërave nga linjat e ndara, referuar si “Mbrojtja e shitur e derivativëve kreditor” duhet të plotësohen kriteret si në vijim: Për kontratat, kundërkëmbimi i kredisë së dështuar/pashlyer të shitura, që janë subjekt i mbylljes, teksti i plotë i paragrafit 4 të aneksit I të Rregullores për treguesin e leverazhit duhet të zbatohet; prandaj, vlera shtesë duhet të kufizohet deri në masën e premive të papaguara. Paragrafi 4 i aneksit I të Rregullores për treguesin e leverazhit duhet të aplikohet për të gjithë derivativët, në librin e bankës apo në atë tregtar.



7.3. Të dhënat duhet të raportohen bruto nga çdo marrëveshje netimi dhe efektit të zbutjes së rrezikut kreditor. Të gjitha bankat duhet të llogarisin ekspozimin e mundshëm të së ardhmes duke përdorur metodën e ekspozimit aktual, edhe nëse ato nuk e përdorin metodën e tillë për rrezikun kreditor nga kundërpala. Për derivativët që tregtohen në bursë apo përmes një kundërpale qëndrore, metoda e ekspozimit aktual përdoret gjithmonë, pa marrë parasysh nëse vlera e ekspozimit për rrezikun kreditor të kundërpalës është zero apo jo.

7.4. Ekspozimi i mundshëm i së ardhmes i derivativëve matet duke përdorur metodën e ekspozimit aktual dhe efektin e netimit, ashtu siç përcaktohet në paragrafët 8 deri 11 të aneksit I të Rregullores për treguesin e leverazhit.

7.5. Të dhënat nuk duhet të përfshijnë asnjë efekt të zbutjes së rrezikut kreditor përveç efektit të netimit.

7.6. Vlera shtesë për derivativët kreditor duhet të llogaritet sipas tekstit të plotë të paragrafit 3 të aneksit I të Rregullores për treguesin e leverazhit. Kjo nënkupton që vlera shtesë e kontratës së kundërkëmbimit të kredisë së dështuar/pashlyer të shitur, subjekt i mbylljes, duhet të kufizohet në masë të premive të papaguara, ndërsa vlera shtesë e kontratës së kundërkëmbimit të kredisë së dështuar/pashlyer të shitur që nuk është subjekt i mbylljes nuk duhet të përfshihet.

7.7. Paragrafi 4 i aneksit I të Rregullores për treguesin e leverazhit duhet të aplikohet për të gjithë derivativët kreditor, qoftë në librin e bankës apo në atë tregtar.

7.8. Gjatë llogaritjes së vlerës shtesë për transaksionet e netuara ( $A_{Net}$  në formulën e paraqitur në paragrafin 11 të aneksit I të Rregullores për treguesin e leverazhit), bankat për llogaritjen e neto koston zëvendësuese nuk duhet të njohin kolateralin e pranuar.

7.9. Shumat nocionale

Bankat duhet të raportojnë shumat nocionale të derivativëve dhe zërave jashtë-bilancor në kolonën 3.

## Tabela 2. Derivatet dhe zërat jashtëbilancorë

### Udhëzimet lidhur me dispozitat specifike

Reshti	Kolona	Referencat ligjore dhe udhëzimet
1		<b>Derivatët</b> <b>Neni 7 par.1 deri 5 dhe par.13</b> të Rregullores për treguesin e leverazhit
2=3-7	2	Ekspozimi i mundshëm i së ardhmes për derivativët që hyjnë në masën e ekspozimit për treguesin e leverazhit. Ekspozimi i mundshëm i së ardhmes që hyn në masën e ekspozimit lidhur me transaksionet e derivativëve sipas nenit 7, par. 1 deri 13 të Rregullores për treguesin e leverazhit.

		Kjo aplikohet për të gjithë derivativët kreditorë të përfshirë në librin e bankës dhe në librin tregtar.
3=4+5+6	1,2,3	Derivativët Ekspozimi i mundshëm i së ardhmes i derivativëve, në rastet e aplikimit të metodës së ekspozimit aktual dhe efektit të netimit.
4	1,3	Derivativët kreditor (mbrojtja e shitur) Ekspozimi i mundshëm i së ardhmes që nuk përmban efekt netimi apo zbutje të rrezikut kreditor, apo shuma nocionale e derivativëve kreditor të shitura që janë subjekt i mbylljes, përfshirë trajtimin e plotë sipas paragrafit 4 të aneksit të Rregullores për treguesin e leverazhit (duke kufizuar vlerën shtesë në masë të premive të papaguara). Aty ku shuma efektive nocionale e derivativëve kreditor të shkruar është përfshirë në masën e ekspozimit dhe nuk është shlyer në pajtueshmëri me nenin 7, par.15 të Rregullores për treguesin e leverazhit, bankat mund të përcaktojnë vlerat e ekspozimeve individuale të mundshme të së ardhmes në vlerën zero për ato derivativë kreditor të shkruar.
5	1,3	Derivativët kreditor (mbrojtja e blerë)  Ekspozimi i mundshëm i së ardhmes që nuk përmban efekt netimi apo zbutje të rrezikut kreditor, apo shumë nocionale të derivativëve kreditor të blerë ( shembull : kur banka blen mbrojtje kreditore nga kundërpala).
6	1,3	Derivativët financiar Ekspozimi i mundshëm i së ardhmes që nuk përmban efekt netimi apo zbutje të rrezikut kreditor, apo shumë nocionale të derivativëve financiar.
7	1,2,3	Ana e kundërpalës qëndrore e përjashtuar për ekspozimet e shlyera tregtare të klientëve (ekspozimi i mundshëm i së ardhmes) Ekspozimi i mundshëm i së ardhmes duke përdorur metodën e ekspozimit aktual dhe duke supozuar që nuk ka efekt netimi apo të zbutjes së rrezikut kreditor që lidhet me anën e kundërpalës qëndrore të përjashtuar për ekspozimet e shlyera tregtare të klientëve (ekspozimi i mundshëm i së ardhmes që plotëson kriteret e përjashtimit sipas nenit 7, par. 11 të Rregullores për treguesin e leverazhit). Ekspozimi i mundshëm i së ardhmes i derivativëve kur aplikohet metoda e ekspozimit aktual dhe efekti i netimit, apo shuma nocionale për anën e kundërpalës qëndrore të përjashtuar për ekspozimet e shlyera tregtare të klientëve sipas nenit 7, par.11 të Rregullores për treguesin e leverazhit.
8		<b>Zërat jashtë-bilancor</b>

		<b>Neni 9</b> i Rregullores për treguesin e leverazhit
9=10+11	3	Zërat jashtëbilancor me 0% Faktor konvertues kreditor sipas Qasjes së Standardizuar për rrezikun kreditor, prej të cilave:
10	3	Zotimet e kartelave kreditore pa kushte të anulimit.
11	3	Zotimet tjera që nuk kanë kushte të anulimit
12	3	Zërat jashtëbilancor me 20% faktor konvertues kreditor sipas Qasjes së Standardizuar për rrezikun kreditor
13	3	Zërat jashtëbilancor me 50% faktor konvertues kreditor sipas Qasjes së Standardizuar për rrezikun kreditor
14	3	Zërat jashtëbilancor me 100% faktor konvertues kreditor sipas Qasjes së Standardizuar për rrezikun kreditor
15=9+12+13+14	3	Gjithsej zërat jashtëbilancor

### 8. Ekspozimet nacionale të rregulluara për derivativët kreditor të shkruar të librit të bankës dhe të librit tregtar.

Tabela 3. Ekspozimet nacionale të rregulluara për derivativët kreditor të shkruar të librit të bankës dhe të librit tregtar.

#### Udhëzimet lidhur me dispozitat specifike

<b>Rreshti</b>	<b>Kolona</b>	<b>Referencat ligjore dhe udhëzimet</b>
1=2+3	1	<b>Neni 7 par. 14 deri 16</b> të Rregullores për treguesin e leverazhit
2	2	Derivativët kreditor (mbrojtja e shitur)  Vlera nacionale e kufizuar e derivativëve kreditor (p.sh., kur banka jep mbrojtje kreditore ndaj një kundërpale)
3	1,2,3	Derivativët kreditor (mbrojtja e blerë)  Vlera nacionale e kufizuar e derivativëve kreditor të blerë (d.m.th., kur banka blen mbrojtje kreditore nga një kundërpalë)  Vlera nacionale e kufizuar e derivativëve kreditor të blerë (p.sh., kur banka blen mbrojtje kreditore nga një kundërpalë) me të njëjtin emër referencë bazë sikurse derivativët kreditor të shkruar nga banka.  Vlera nacionale e kufizuar e derivativëve kreditor të blerë (d.m.th., kur banka blen mbrojtje kreditore nga një kundërpalë) me të njëjtin emër referencë bazë sikurse derivativët kreditor të shkruar nga banka, kur maturiteti i mbrojtjes së blerë është i barabartë me apo më i gjatë se maturiteti i mbrojtjes së shitur.

4=2-3	2,3	Derivatívët kreditor (mbrojtja e shitur minus mbrojtja e blerë)  Paraqet ndryshimin në mes të derivativëve të shkruar dhe të blerë me të njëjtin emër referencë bazë.
-------	-----	---

Supozojmë që Banka A ka shitur mbrojtje kreditore në vlerë prej 100€ të borxhit të Korporatës X me afat 5 vjeçar, dhe ka blerë mbrojtje kreditore për të njëjtin borxh përmes transaksioneve në vijim: (a) 40€ për 5 vite; (b) 40€ për dy vite; (c) 20€ për gjashtë muaj dhe duke supozuar që Banka A nuk ka hyrë në transaksione tjera të derivativëve kreditor, shumat nocionale të mbrojtjes kreditore të shkruar dhe të blerë sipas kriterëve të përshkruara më lartë janë si më poshtë:

	Shuma nocionale e kufizuar	Shuma nocionale e kufizuar (me emër referencë të njëjtë)	Shuma nocionale e kufizuar (referencë e njëjtë me maturitet të njëjtë)
Derivatívët kreditor (mbrojtja e shitur)	100		
Derivatívët kreditor (mbrojtja e blerë)	100	100	40

## 9. Llogaritja e treguesit të leverazhit

Tabela 4. Llogaritja e treguesit të leverazhit

Rreshti	Referencat ligjore dhe udhëzimet
1	Kapitali i klasës së parë (sipas Rregullores për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave)
2	Gjithsej ekspozimet
3	Rregullimet rregullatore <b>Neni 6 i</b> Rregullores për adekuatshmërinë e kapitalit të bankave
4=2-3	Gjithsej ekspozimet për llogaritjen e Treguesit të leverazhit
5=1/4	Treguesi i leverazhit <b>Neni 3 i</b> Rregullores për treguesin e leverazhit

Fehmi Mehmeti

Kryesues i Bordit Ekzekutiv